

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6912
E shtunë, 3 qershor 2023
Çmimi 0.40 €

Senatori Murphy kërkon "angazhim agresiv" të ShBA-së në Ballkan



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS DEBATON PËR VERIUN DHE RAPORTET E LËNDUARA ME SHETETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA)

SITUATA NË VERI DHE RAPORTET ME SHBA-në PËRPLASIN KRYEMINISTRIN ME OPOZITËN



- Opozita, Kurtit: Nuk të lejojmë t'i rrezikosh raportet e shenjta me ShBA-në

Situata në veriun e Kosovës dhe lëkundja e raporteve me ShBA-në ka përplasar të premten kryeministrin Albin Kurti me opozitën në Kuvendin e Kosovës. Kurti ka thënë se vendimi për t'i dërguar kryetarët në objektet komunale në veri nuk ka qenë politik,

por i sigurisë. Ai ka theksuar se tensionimin e situatës në veri e kanë bërë bandat nga Serbia, duke paralajmëruar arrestimin e tyre. Ndërsa liderët e opozitës, Memli Krasniqi, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, e kanë akuzuar

Kurtin se e ka dërguar policinë në veri pa koordinim me partnerët ndërkombëtarë, veçmas ShBA-në. Duke iu referuar lëkundjes së raporteve me ShBA-në, ata kanë thënë se nuk do ta lejojnë Kurtin t'i rrezikojë raportet e shenjta me Amerikën

AHMETI VIZITON FAMILJEN E THAÇIT: KRENARË DO TA PRESIM BASHKË HASHIMIN ME SHOKË NË RIKTHIMIN E TIJ SI FITUES I DREJTËSISË!



Kryetari i BDI-së dhe një nga themeluesit e UÇK-së, Ali Ahmeti, ka vizituar familjen e Hashim Thaçit. Ahmeti ka thënë se ka shkuar në Burojë të Skenderajt për t'i inkurajuar dhe për t'u dhënë zëmër dhe forcë prindërve të Thaçit, ku djali i tyre është duke e mbrojtur me dinjitet luftën e UÇK-së. Ai është shprehur i bindur se Thaçi dhe të

tjerët do të triumfojnë në Gjykatën Speciale. "Drejtesia vonon, por nuk harron, kështu i thashë bacës Haxhi kur po kuvendonim mbi vitet e qëndresës kombëtare për lirinë dhe shtetësinë e Kosovës. Krenarë do ta presim bashkë Hashimin me shokë në rikthimin e tij si fitues i drejtësisë! Liria ka emër!", ka thënë Ahmeti

RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

ASK-ja: QEVERIA PËR TRE MUAJ SHPENZOI 511.8 MILIONË EURO

KËRKOHEM QË AGJENCITË TURISTIKE TË PAJISEN ME LEJE

SPORT
FEDERATA RUMUNE I KËSHILLON TIFOZËT TË KENË KUJDES GJATË QËNDRIMIT NË KOSOVË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shmanget kriza financiare në ShBA, Senati miraton rritjen e kufirit të borxhit

WASHINGTON, 2 QERSHOR - Senati i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) ka miratuar projektligjin për rritje të tavanit të borxhit të ShBA-së, duke mundësuar që qeveria amerikane të vazhdojë t'i paguajë faturat e saj.

Propozimi është miratuar me 63 vota për dhe 36 kundër, katër ditë përpara se ShBA-ja të falimentonte. Sipas procedurës, Ligji duhet të nënshkruhet nga presidenti amerikan Joe Biden. "Sonte senatorët nga të dyja partitë votuan për ta mbrojtur përparimin ekonomik të arritur me vështirësi dhe për ta parandaluar falimentimin e parë ndonjëherë të Shteteve të Bashkuara", ka thënë presidenti Biden.

Dhoma e Përfaqësuesve e kaloi



ligjin me mbështetje të gjerë nga ligjvënësit republikanë dhe demokratë të mërkurën, për ta lejuar qeverinë të vazhdojë të marrë hua më shumë para për t'i përmbushur detyrimet e saj financiare, duke tejkaluar tavanin aktual të borxhit prej 31.4 trilionë dollarësh.

Autoriteti i huamarrjes do të zgjatet deri më 2 janar 2025, dy muaj pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 2024. Për më tepër, projektligji kërkon mbajtjen e shumicës së shpenzimeve federale në nivelet aktuale gjatë vitit të ri fiskal që fillon në tetor, me një rritje prej 1-përqindësh

gjatë 12 muajve të ardhshëm.

"Gjëja përgjegjëse për Amerikën është ta miratojë atë", ka thënë senatori demokrat Dick Durbin përpara votimit. Si udhëheqës i shumicës demokratike në Senat, Chuck Schumer, ashtu edhe kreu i pakicës republikane, Mitch McConnell, mbështetën shfuqizimin e kufirit të borxhit dhe bënë thirrje për miratimin e shpejtë të projektligjit. "Koha është një luks që Senati nuk e ka nëse duam ta parandalojmë falimentimin. Nuk ka asnjë arsye të mirë për të mos përfunduar këtë proces. Vendi nuk mund ta përballojë këtë tani", ka thënë Schumer.

Dhoma e Përfaqësuesve e miratoi projektligjin me 314 vota kundër 117 kundër pavarësisht prej kundërshtimeve nga

përfaqësuesit republikanë të ekstremit të djathtë, të cilët thanë se ai nuk shkoj aq larg sa duhet në shkurtimin e shpenzimeve.

Demokratët, nga ana tjetër, kanë thënë se ligji shkurton shumë shpenzimet e qeverisë.

Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, republikan, ka thënë se miratimi i projektligjit "nuk ishte një luftë e lehtë". "Ne vendosëm qytetarët e Amerikës në rend të parë dhe morëm një rrugë më të lehtë. Ne nuk e ngritëm vetëm tavanin e borxhit, si në të kaluarën, por arritëm të shpenzojmë edhe më pak", ka thënë McCarthy. Kjo masë nuk rrit taksat dhe nuk parandalon rritjen e mëtejshme të borxhit kombëtar, i cili vlerësohet të jetë 3 trilionë dollarë të tjerë deri në janar të vitit 2025.

Zvicra bllokoi eksportet indirekte të armëve në Ukrainë

BERNË, 2 QERSHOR - Parlamenti zviceran më 1 qershor hodhi poshtë një projektligj që kërkonte mundësimin e transferimit të armëve nga Zvicra në Ukrainë. Shumica e anëtarëve të Këshillit Kombëtar Zviceran votuan kundër këtij propozimi që ishte hartuar nga komiteti i politikës së sigurisë të dhomës më të madhe parlamentare të vendit.

Asambleja Federale e Zvicrës përbëhet nga Këshilli Kombëtar dhe Këshilli më i vogël i Shteteve. Projektligji që mbante emrin "Lex Ukraine" do të kishte lejuar shtetet e tjera të dërgonin materiale luftarake të prodhuara nga Zvicra në Ukrainë. Ligjet e Zvicrës neutrale ndalojnë

mbështetjen për vendet e përfshira në akte lufte. Prandaj, Zvicra deri më tani ka refuzuar t'i japë Gjermanisë lejen për t'i kaluar municionet zvicerane - të blera vite më parë për tankun gjerman Leopard - në Ukrainë. Sipas ligjeve të saj të neutralitetit dhe një embargoje të veçantë për armët, Zvicra e ka të ndaluar të dërgojë armë direkt në Ukrainë. Ministria zvicerane e Mbrojtjes, Viola Amherd, përmes një letre më 1 mars tha se një shitje e mundshme e një pjese të flotës së tankeve zvicerane do të kërkonte që Parlamenti zviceran të deklaronte zyrtarisht se tanket janë jashtë shërbimit.

Ushtria zvicerane aktualisht ka

134 tanke Leopard 2 në shërbim dhe 96 të magazinuara. Qeveria nuk kishte bërë me dije numrin e tankeve që Gjermania ka kërkuar t'i bëjë, por një zyrtar zviceran tha se një gjë e tillë mund të bëhej me një numër të kufizuar të tankeve. Zvicra më parë ka bllokuar kërkesat e Gjermanisë, Spanjës dhe Danimarkës për të lejuar riekportimin e municioneve të prodhuara në Zvicër, në Ukrainë. Por çështja po bëhet gjithnjë e më përçarëse në Zvicër, ku duket se Ukraina ka mbështetje të gjerë në publik dhe politikë, duke bërë që të shtohet presioni ndaj qeverisë për t'i dhënë fund ndalimit të eksporteve të armëve zvicerane në zonat e luftës. Thirrjet nga



fqinjët evropianë për Zvicrën për të lejuar transferime të tilla në Kiev janë shtuar, dhe dy komitetet

e sigurisë së Parlamentit kanë rekomanduar që rregullat të lehtësohen.

ShBA-ja revokon vizat për inspektorët bërthamorë të Ruisë

WASHINGTON, 2 QERSHOR - Administrata e presidentit amerikan, Joe Biden, ka marrë masa, duke ukundërpërgjigjur ndaj vendimit të Ruisë për ta pezulluar traktatin bërthamor START. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë njoftuar për revokimin e vizave për inspektorët bërthamorë rusë, refuzimin e aplikacioneve në pritje për monitoruesit e rinj dhe anulimin e lejeve standarde për avionët rusë për të hyrë në hapësirën ajrore të ShBA-së.

Në vazhdim të "shkeljeve të vazhdueshme" të Ruisë të traktatit START, Departamenti Amerikan i Shtetit ka njoftuar për ndërmarrjen e masave të ndryshme si kundërpërgjigje. Departamenti i Shtetit ka theksuar angazhimin e



Shteteve të Bashkuara për zbatimin e plotë dhe reciprok të traktatit por, "trjedhimisht, në përputhje me këtë angazhim, Shtetet e Bashkuara kanë zbatuar kundërmasa të ligjshme për t'i adresuar shkeljet e vazhdueshme të traktatit nga Rusia".

Departamenti ka theksuar se revokimet e vizave dhe refuzimet e aplikacioneve, si dhe një vendim për ta ndaluar shpërndarjen e informacionit mbi statusin ose

vendndodhjen e raketave dhe të dhënave për lëshimet testuese të Ruisë, ishin në përputhje me ligjin ndërkombëtar për shkak të veprimeve të Ruisë.

Shtetet e Bashkuara, megjithatë, do të vazhdojnë të njoftojnë Ruisë kur t'i kryejë lëshimet testuese, tha Departamenti, duke shtuar se hapat që ajo po ndërmer ish në këtyre shtetëve me kusht që Moskë të rikthehet dhe respektojë traktatin. Elementet thelbësore të traktatit START, të nënshkruar nga ish-presidentët Barack Obama dhe Dmitry Medvedev në vitin 2010, përfshijnë lejin e inspektimeve të objekteve të armëve dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me vendosjen e raketave balistike ndërkontinentale.

Në mars ShBA-ja ka njoftuar se ajo dhe Rusia kishin ndaluar shkëmbimin e informacioneve të armëve bërthamore.

Edhe pse START ishte zgatur pak pasi presidenti Joe Biden ka marrë detyrën në janar të vitit 2021, konflikti i vazhdueshëm në Ukrainë e ka tensionuar traktatin. Që kur presidenti rus Vladimir Putin ka deklaruar se Rusia nuk do t'u përmbahet më detyrimeve të saj sipas traktatit, START ka qenë në prag të kolapsit.

Brenda traktatit ka dispozita specifike që i kufizojnë të dyja vendet që të kenë një maksimum prej 1 550 kokash bërthamore. Marrëveshja përfshin, gjithashtu, inspektime gjithëpërfshirëse në vend për të siguruar se vendet janë

në bashkërendim me këto kufizime.

Inspektimet janë mbyllur në vitin 2020 për shkak të pandemisë Covid-19. Diskutimet për rifillimin e tyre supozohej të zhvilloheshin në nëntor të vitit 2022, por Rusia i anuloi befas, duke cituar mbështetjen e ShBA-së për Ukrainën.

Departamenti i Shtetit ka thënë se Rusia i ishte thënë paraprakisht për kundërmasa, por ka nënvizuar që Uashingtoni është ende i interesuar të mbajë gjallë traktatin. "Shtetet e Bashkuara mbeten të gatshme të punojnë në mënyrë konstruktive me Ruisë për rifillimin e zbatimit të Traktatit START", është thënë në deklaratën e Departamentit Amerikan të Shtetit.

Ahmeti viziton familjen e Thaçit: Krenarë do ta presim bashkë Hashimin me shokë në rikthimin e tij si fitues i drejtësisë!

Kryetari i BDI-së dhe një nga themeluesit e UÇK-së, Ali Ahmeti, ka vizituar familjen e Hashim Thaçit. Ahmeti ka thënë se ka shkuar në Burojë të Skenderajt për t'i inkurajuar dhe për t'u dhënë zemër dhe forcë prindërve të Thaçit, ku djali i tyre është duke e mbrojtur me dinjitet luftën e UÇK-së. Ai është shprehur i bindur se Thaçi dhe të tjerët do të triumfojnë në Gjykatën Speciale. "Drejtësia vonon, por nuk harron, kështu i thashë bacës Haxhi kur po kuvendonim mbi vitet e qëndresës kombëtare për lirinë dhe shtetësinë e Kosovës. Krenarë do ta presim bashkë Hashimin me shokë në rikthimin e tij si fitues i drejtësisë! Liria ka emër!", ka thënë Ahmeti

EPOKA
ERE

Lirim GECI

Prishtinë, 2 qershor (ER) - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, ka vizituar prindërit e Hashim Thaçit në Burojë të Skenderajt. Ahmeti, i cili ka qenë një ndër figurat qendrore të UÇK-së, ka bërë me dije se u ka dhënë forcë prindërve të Thaçit për betejën ligjore që biri i tyre më shokë është duke e zhvilluar në Gjykatën Speciale në Hagë.

Po ashtu, Ahmeti ka thënë se do t'i presin krenarë Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin si fitues të drejtësisë. "Vizitova sot vatrën familjare të bashkëveprimtarit tim dhe ish-presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, për



t'ju dhënë zemër e forcë prindërve dhe të afërmeve të tij në betejën e drejtësisë, ku djali i tyre me shokë po mbron dinjitetin e UÇK-së, kauzën e pastër të mbarë popullit të Kosovës. Drejtësia vonon, por nuk harron, kështu i thashë bacit Haxhi kur po

kuvendonim mbi vitet e qëndresës kombëtare për lirinë dhe shtetësinë e Kosovës. Krenarë do ta presim bashkë Hashimin me shokë në rikthimin e tij si fitues i drejtësisë! Liria ka emër!", ka shkruar Ahmeti në "Facebook". Hashim Thaçi, Kadri Veseli,



Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga viti 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar në muajin prill të këtij viti. Seancat gjyqësore janë duke u mbajtur të mbyllura për publikun, gjë që kanë shkaktuar pakënaqësi jo

vetëm te mbrojtja e liderëve të UÇK-së, por edhe te njohësit e çështjeve juridike. Pavarësisht prej kësaj, Thaçi me shokë janë deklaruar të pafajshëm ndaj të gjitha pikave të aktakuzave me të cilat është duke i ngarkuar Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS).



Kosova i bën kërkesë zyrtare Serbisë për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, nis me Drenicën

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Kryetari i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, Andin Hoti, ka bërë me dije se Kosova ka filluar kërkesat e saj ndaj Serbisë për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Hoti ka thënë se në shkresën e parë zyrtare drejtuar Serbisë, Kosova ka kërkuar arkivat që do të ndihmojnë në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur

me forcë gjatë luftës. "Në respektim të zbatimit të Deklaratës për Persona të Zhdukur, e miratuar në Bruksel, Republika e Kosovës pa humbur kohë ka filluar me kërkesat e saj për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Shkresa që po e publikoj këtu, është vetëm shkresa e parë drejtuar Serbisë, për të kërkuar arkivat që do të



ndihmojnë në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me force

gjatë luftës. Ne kemi kërkuar nga Presidenti i Serbisë, të gjitha informacionet, përfshirë edhe ato të klasifikuara, për Komandën e Brigadës së Motorizuar të 37-të të Ushtrisë Jugosllave. Kjo brigadë, përveç tjerash ka kryer krime në regjion të Drenicës. Nga masakrat e kryera në fshatrat e Drenicës nga kjo njësi, ka ende civilë shqiptarë të zhdukur", ka

deklaruar Hoti.

Ai ka thënë se është e natyrshme që shkresa e parë të fillojë me Drenicën pasi, sipas tij, pikërisht në Drenicë Serbia ka filluar krimet masive ndaj popullit shqiptar. "Natyrshëm që shkresa e parë fillon me Drenicën, sepse pikërisht në Drenicë, Serbia ka filluar me krimet masive ndaj popullit shqiptar", ka thënë Hoti.

Kimberly West emërohet prokurore në Gjykatën Speciale në Hagë

HAGË, 2 QERSHOR - Ish-prokurore federale amerikane Kimberly West është emëruar prokurore e specializuar në Gjykatën Speciale të Hagës, e cila heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i

vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. West do ta marrë detyrën që më parë u krye nga Jack Smith, i cili u largua nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në nëntor të vitit 2022, për të marrë një pozicion si prokuror për hetimet ndaj ish-presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

Donald Trump. Ajo do të jetë prokurore e tretë e specializuar, pas Jack Smith dhe David Schwendiman. Prokurori amerikan Jack Smith ka mbajtur postin e kryeprokurorit në Dhomat e Specializuara ku hetohen pretendimet për krime të luftës dhe të pasluftës në Kosovë.

Alex Whiting, ushtrues detyre i prokurorit special që nga nëntori i vitit 2022, do të vazhdojë të mbajë këtë detyrë derisa West t'i marrë përgjegjësitë e saj. Në biografinë e saj është thënë se West ka përvojë të gjerë në hetimet penale të brendshme dhe ndërkombëtare me mbi dy



dekada përvojë prokuroriale në role lokale, shtetërore, federale dhe ndërkombëtare.

KUVENDI I KOSOVËS DEBATON PËR VERIUN DHE RAPORTET E LËNDUARA ME SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA)

Situata në veri dhe raportet me ShBA-në përplasnin kryeministrin me opozitën

- Opozita, Kurtit: Nuk të lejojmë t'i rrezikosh raportet e shenjta me ShBA-në

Situata në veriun e Kosovës dhe lëkundja e raporteve me ShBA-në ka përplasur të premten kryeministrin Albin Kurti me opozitën në Kuvendin e Kosovës. Kurti ka thënë se vendimi për t'i dërguar kryetarët në objektet komunale në veri nuk ka qenë politik, por i sigurisë. Ai ka theksuar se tensionimin e situatës në veri e kanë bërë bandat nga Serbia, duke paralajmëruar arrestimin e tyre. Ndërsa liderët e opozitës, Memli Krasniqi, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, e kanë akuzuar Kurtin se e ka dërguar policinë në veri pa koordinim me partnerët ndërkombëtarë, veçmas ShBA-në. Duke iu referuar lëkundjes së raporteve me ShBA-në, ata kanë thënë se nuk do ta lejojnë Kurtin t'i rrezikojë raportet e shenjta me Amerikën

**EPOKA E RE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Në Kuvendin e Kosovës të premten është debatuar për veriun e vendit. Kryeministri Albin Kurti është ftuar nga Kryesia e Kuvendit të deklarojë për situatën e krijuar atje dhe për raportet e lëkundura me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ky debat është përcjellë me akuza dhe kundërrakuzat në mes të pozitës dhe opozitës për situatën e krijuar në veri dhe raportet me ShBA-në. Fillimisht kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë para deputetëve se kryetarët e rinj të komunave në veri të Kosovës janë shoqëruar me forca të sigurisë për shkak se është dashur të sigurohet hyrja e tyre në objekte komunale pa pengesa. Kurti ka theksuar se ky veprim nuk ishte vendim politik, por i sigurisë. “Në këtë pikë më duhet të theksoj se shoqërimi i kryetarëve të rinj me forca të sigurisë është vlerësim i institucioneve të sigurisë që vlerësojnë shkallën e rrezikshmërisë, pra nuk është vendim politik, por unë si kryeministër e mbështes këtë edhe atëherë, edhe sot”, është shprehur Kurti, duke shtuar se e mbështet këtë vendim pasi që incidentet në ditët në vijim kanë dëshmuar se kishte rrezik për sulme nga bandat kriminale, të dirigjuara nga Serbia. Më tutje, Kurti ka thënë se këto protesta në veri nuk janë vullnet i

serbëve që jetojnë në ato komuna, por janë të organizuara nga Beogradi zyrtar. “Jam i vetëdijshëm që jo të gjithë ata që po marrin pjesë në grumbullimet para objekteve janë pjesë e bandave kriminale, por janë të detyruar të shërbejnë si mburojë njerëzore”, ka thënë Kurti, duke shtuar se presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është penduar që i ka thënë po marrëveshjes së Brukselit. Ai ka thënë se Vuçiqi e di që marrëveshja e Brukselit “është e mirë për Kosovën dhe refuzon ta nënshkruajë”. Kurti në fjalën e tij situatën në veri e ka quajtur “të tensionuar dhe të rrezikshme”, por ka theksuar se nuk mund të kontribuojë në krijimin e strukturave paralele në veri sepse “nëse objektet komunale nuk janë për kryetarë, atëherë për kë janë?”. “Legjitimiteti (i kryetarëve) është i vakët, mirëpo legaliteti është i plotë. Dhe ata që na kritikojnë për legjitimitet nuk kanë legjitimitet sepse i kanë braktisur institucionet”, ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se tani është në pyetje “çlirimi i komunitetit serb nga milicia fashiste” dhe se ky komunitet ka nevojë për pluralizëm politik.

I pari i qeverisë ka thënë se Lista Serbe duhet t'i paguajë vetë pasojat për tërheqjen nga institucionet e Kosovës dhe bojkotimin e zgjedhjeve në katër komunat në veri të Kosovës dhe kërkoi që për vendimet e tyre të

mos ndëshkohet Kosova. “Nuk jemi kundër serbëve. I kemi ftuar të kthehen në institucione, mirëpo gabimin kardinal të Listës Serbe që i bojkotoi zgjedhjet, që i braktisi zgjedhjet, nuk duhet ta paguajë Republika jonë, por Lista Serbe”, ka thënë Kurti. Ai ka vlerësuar se eskalimi i situatës më 29 maj, kur ushtarë të KFOR-it mbetën të lënduar, ishte “e planifikuar mirë” dhe e orkestruar nga Beogradi. Po ashtu, ai ka vlerësuar se protestuesit në veri të Kosovës nuk po kërkojnë zgjedhje të reja komunale, teksa ka theksuar se “pushteti në Kosovë mund të merret veç me zgjedhje, jo me sulme e granata”.

Opozita, Kurtit: Nuk të lejojmë t'i rrezikosh raportet e shenjta me ShBA-në

Paraqitja e kryeministrit Kurti në Kuvend dhe zhvillimet në veri nuk kanë kaluar pa kritika të ashpër nga opozita parlamentare. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri të vendit janë kryer “kye në vete” dhe se nuk ishin në bashkërendim me aleatët, veçmas me ShBA-në. “Për herë të parë na ke sjellë në një situatë të na dënojë publikisht sekretari amerikan i shtetit. Jo vetëm ai, por ai është më i rëndësishmi sepse raporti ynë me ShBA-në është i shenjtë. Nuk të lejojmë ta rrezikosh atë sepse është i shenjtë”, ka thënë Krasniqi, duke iu referuar deklaratës së Antony Blinkenit. “Sovranitetin nuk mund ta mbash as në zyrën tënde pa e pasur mbështetjen e ShBA-së”, ka thënë Krasniqi. Sipas tij, edhe mbajtja e procesit zgjedhor në katër komunat në veri të Kosovës - Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe Mitrovicë të Veriut - ka ndodhur për shkak për shkak të “gabimeve të Kurtit”, duke

iu referuar vendimit të Qeverisë së Kosovës për rirregjistrimin e veturave nga targa KM në RKS, i cili ka ndikuar në dorëheqjen e punonjësve serbë nga institucionet e Kosovës. “Në fund je tërhequr, pse nuk po e përmend?! Nuk ka askund targa. Dhe në fund, çka ka ndodhur? Është dashur të hyje në proces zgjedhor”, ka thënë ai. Krasniqi i ka thënë Kurtit le ta harrojë se mund të organizojë zgjedhje të parakohshme në veri, veçmas në dy komunat ku ka fituar PDK-ja, Zubin Potok dhe Zveçan. Po ashtu, ai i ka thënë Kurtit që të shkojë bashkë në veri, pasi ky i fundit ka kërkuar nga liderë e opozitës se a duhet t'i arrestojnë kriminelët serbë me apo pa koordinim.

Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se partia e tij do ta “parandalojë me çdo mjet rëshqitjen strategjike të Republikës së Kosovës”. Ai ka thënë se pa koordinim me aleatët perëndimorë, Kosova nuk mund t'i realizojë as të drejtat e saj. Abdixhiku ka thënë se partia e tij kishte vendosur të mos garojë në zgjedhjet në katër komunat në veri të Kosovës - Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe Mitrovicë të Veriut - pasi që ndiente se nuk mund t'i përfaqësojë banorët në këtë zonë të banuar me shumicë serbe. “Ndonëse LDK-ja nuk garoi, ne e kemi mbështetur garën e dy partive politike sepse besojmë që kjo është e drejta e një shteti të pavarur demokratik. Sot kjo e drejtë e jona, pa Perëndimin e pa aleatë, nuk ka gjasë të ekzistojë”, ka thënë Abdixhiku gjatë fjalimit të tij në Kuvendin e Kosovës.

I pari i LDK-së ka thënë se Kosova historikisht ka bashkëpunuar me ShBA-në dhe aleatet e saj për t'i arritur të drejtat e saj dhe tha se “ky nuk është nënshtrim, është mençuri”. Ai ka theksuar se nga

mosbashkëpunimi i tillë “do të ketë dëme të pariparueshme për shtetin e Kosovës dhe më pas do t'i vuajmë të gjithë”.

Në anën tjetër, lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kërkuar shkarkimin e qeverisë së kryeministrit Kurti, duke i ftuar deputetët të nisin mocion mosbesimi ndaj Qeverisë së Kosovës. Haradinaj ka thënë se kritikën e Kurtit në adresë të sekretarit Blinken ngjasojnë me ato të ministrit të Jashtëm të Ruisisë, Sergey Lavrov. “Mosbesimi deri në pabesi nga ana e kryetarit të Qeverisë së Kosovës ndaj aleatëve të sigurisë që janë ende garanci e sigurisë sonë. Kush përfiton nga kjo, përveç (presidentit të Ruisisë, Vladimir) Putinit dhe Ruisisë? Për këtë ju kërkoj të shkojmë në mocion dhe ta ndërpresim mosbesimin deri në pabesi dhe ta shkarkojmë qeverinë Kurti”, ka thënë Haradinaj gjatë fjalimit të tij.

Zgjedhjet në katër komunat në veri, të banuara me shumicë serbe, janë mbajtur më 23 prill, pas dorëheqjes së kryetarëve nga radhët e Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve të Kosovës, në nëntor të vitit të kaluar. Zgjedhjet janë bojkotuar nga popullata shumicë serbe në atë zonë, që tani nuk i pranon kryetarët e rinj. Përshkallëzimi i situatës në veri ka kulmuar të hënën, më 29 maj, kur trupat paqeruajtëse të KFOR-it kanë ndërhyrë në Zveçan “për t'i shmangur përplasjet mes palëve dhe për ta zvogëluar rrezikun e përshkallëzimit”. Nga përleshja në mes të protestuesve dhe KFOR-it janë lënduar 30 ushtarë të misionit NATO-s.

Shtetet e Bashkuara dhe aleatët kanë vlerësuar se përdorimi i forcës minon përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi dhe kanë bërë thirrje për qetësim të situatës.



Pas tensioneve në veri, në javën tjetër Lajçaku dhe Escobari vizitojnë Kosovën dhe Serbinë

Bruksel, 2 qershor - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian (BE) për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak dhe i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkan, Gabriel Escobar, pritet që në javën tjetër t'i vizitojnë Kosovën dhe Serbinë, më saktësisht të hënën dhe të martën, kanë bërë me dije burimet diplomatike në Bruksel për "Radion Evropa e Lirë".

Vizita e tyre, sipas këtyre burimeve, do të ketë dy qëllime kryesore. Qëllimi i parë është gjetja e zgjidhjes për të dalë nga situata aktuale e cila rrezikon të dëmtojë gjithë atë që BE-ja e konsideron si sukses në dialog. Pra, fokusi së pari do të jetë në uljen e tensioneve dhe vazhdimin e përpjekjeve në bazë të asaj që është propozuar pas takimit në Moldavi.

Ndërsa qëllimi i dytë do të jetë vazhdimi i punës në sekuencimin e hapave për ta zbatuar marrëveshjen e arritur në Bruksel dhe aneksin për të cilin palët ishin pajtuar në Ohër.

Bashkimi Evropian (BE) e kishte quajtur arritjen e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të

raporteve si një "dalje nga faza e menaxhimit në krizave në një fazë të normalizimit", mirëpo për shkak të përshkallëzimit të situatës ditët e fundit në veri të Kosovës, për çka përgjegjësia iu bart autoriteteve të Kosovës, të cilat insistuan që kryetarët e zgjedhur të komunave të hynë në ndërtesa, prapë aktiviteti i BE-së është kthyer në menaxhimin e krizave.

Diplomatët në BE kanë thënë se duhet siguruar që tensionet e fundit në veri të mos e rrezikojnë marrëveshjen e arritur, prandaj bëjnë thirrje që tensionet të ulen menjëherë dhe në mënyrë të pa kusht, dhe që palët t'i kthehen dialogut dhe procesit të normalizimit.

Protestat në tri komunat në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe - kanë filluar më 26 maj, kur grupe të serbëve lokalë janë grumbulluar para objekteve komunale për të protestuar kundër hyrjes së kryetarëve të rinj shqiptarë të Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit në to.

Përshkallëzimi në veri të Kosovës kulmoi të hënën, më 29 maj, kur trupat paqeruajtëse të KFOR-it



ndërhynë në Zveçan "për t'i shmangur përplasjet mes palëve dhe për ta minimizuar rrezikun e përshkallëzimit", dhe janë sulmuar nga disa protestues të dhunshëm, që Qeveria e Kosovës thotë se ishin "banda kriminale serbe".

Nga kjo përlëshje, 30 ushtarë të KFOR-it kanë mbetur të lënduar. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët kanë thënë se përdorimi i forcës minon përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi dhe bënë thirrje për qetësim të situatës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, vazhdimisht i ka mbrojtur veprimet e Policisë së Kosovës, e cila ndihmoi instalimin e kryetarëve të rinj shqiptarë në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, përkundër rezistencës së banorëve lokalë.

Senatori Murphy kërkon "angazhim agresiv" të ShBA-së në Ballkan

UASHINGTON, 2 QERSHOR - Anëtari i Komisionit për Punë të Jashtme të Senatit Amerikan, Chris Murphy, ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) duhet të angazhohen "në mënyrë agresive" në Ballkan. Ai i fajësoi autoritetet e Kosovës për tensionet aktuale në veri të vendit. "Ne duhet të angazhohemi në mënyrë agresive në Ballkan për ta mbrojtur paqen, sepse tani nuk mund ta përballojmë shuarjen e zjarreve të vërteta në atë rajon", ka thënë Murphy në një intervistë për "National Journal" pas kthimit në Uashington nga një turnir ballkanik.

Tensionet në veri të Kosovës janë të larta prej se Policia e Kosovës ndihmoi kryetarët shqiptarë të tri komunave me shumicë serbe - Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq - të hyjnë në ndërtesat komunale, më 26 maj, pavarësisht prej rezistencës së banorëve lokalë.



Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, e ka fajësuar Qeverinë e Kosovës për veprimet që çuan në "përshkallëzim të tensioneve në veri dhe rritje të destabilitetit".

Murphy, i cili është takuar me

kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në Prishtinë, më 22 maj, është pajtuar me Blinkenin se situata mund të ishte zgjidhur me diplomaci dhe jo me forcë. "Ai nuk duhej të lëvizte aq shpejt me vendimin për t'i marrë ato ndërtesa

komunale. Ai mund të priste dhe të përpiqej ta zgjidhte këtë nëpërmjet ndërmjetësve si Shtetet e Bashkuara", ka thënë senatori amerikan.

Kjo situatë, sipas tij, i ka dhënë Rusisë mundësi për të nxitur trazira. "Rusia luan lojëra në Ballkan. Ajo përpiqet të nxisë përçarje dhe konflikte. Ajo shpreson se do të ketë konflikt në Ballkan, një konflikt real kinetik që do t'i largonte Shtetet e Bashkuara dhe Evropën nga konflikti në Ukrainë", ka thënë Murphy.

Murphy ka thënë se shpreson që kur të qetësohet situata në veri të Kosovës, njerëzit ta kthejnë vëmendjen te zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit për normalizimin e marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit.

Një ditë më herët, kryeministri Kurti ka bërë me dije se ka biseduar me zëvendëskëshilltarin amerikan për siguri kombëtare, Jon Finer, dhe senatorët Chris Murphy, Pete

Ricketts dhe Jeanne Shaheen ku, sipas tij, ka theksuar përkushtimin "për të punuar me ShBA-në për t'i ulur tensionet" në veri të Kosovës. "Kjo (ulja e tensioneve) kërkon përfundim të menjëhershëm të dhunës nga turmat e sponsorizuara nga Beogradi kundër zyrtarëve të sigurisë deri në zgjedhjet e reja në ato komuna", thuhet në postimin e Kurtit në "Twitter".

Përpjekjet ndërkombëtare për t'i ulur tensionet në Kosovë janë shtuar, ndërsa serbët vazhdojnë protestat në pjesën veriore të vendit kundër kryetarëve shqiptarë të komunave. Kërkesat e tyre janë që këta kryetarë, të dalë nga zgjedhjet e 23 prillit, të tërhiqen nga komunat me shumicë serbe, ashtu si edhe njësitet speciale të Policisë së Kosovës. Gjatë një adresimi më 31 maj, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka refuzuar ato, por la të hapur mundësinë për zgjedhje të reja lokale.

Krasniqi takohet me Hovenierin: Raporti i Kosovës me ShBA-në, i shenjtë, i pazëvendësueshëm dhe i përhershëm

Prishtinë, 2 qershor (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, është takuar të premten me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

(ShBA) në Prishtinë, Jeffrey Hovenier. Me këtë rast, Krasniqi ka thënë se raporti i Kosovës me ShBA-në është i shenjtë, i pazëvendësueshëm dhe i përhershëm. "Raporti i

Kosovës me ShBA-në është i shenjtë, i pazëvendësueshëm dhe i përhershëm. Diskutime të frytshme dhe miqësore me ambasadorin amerikan Jeffrey Hovenier, sot, gjatë

një dreke pune në rezidencën e tij", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". Takimi i Krasniqit me Hovenierin vjen në kohën e situatës së tensionuar në veri të Kosovës dhe kërkesës



amerikane dhe evropiane për shtensionimin e situatës atje.

Hamza nënshkruan kontratat e bursave për 230 studentë mitrovicas



MITROVICË, 2 QERSHOR - Në hapësirat e muzeut të qytetit, kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka nënshkruar kontratat për bursa me 230 studentë për vitin akademik 2022/2023. Me rastin e nënshkrimit të kontratave, i pranishëm ishte edhe drejtori i Drejtorisë së Administratës, Gëzim Stavileci, i cili i ka përgëzuar të gjithë studentët bursistë të cilët, falë

angazhimit të tyre, kanë arritur t'i përmbushin kriteret e të jenë përfitues të bursës komunale. Kryetari Hamza ka thënë se me bindje të plotë i qëndron fjalës së tij se investimi në arsim është investimi më i nevojshëm në shoqërinë tonë, duke shtuar se financimi i bursave asnjëherë nuk llogaritet si shpenzim, përkundrazi është investimi më i duhur për të ardhmen.

“Ndihe shumë krenar që kemi arritur ta rritim numrin edhe për 180 bursa për studentët e Mitrovicës dhe padyshim që kjo mbështetje financiare nga institucionet lokale do të shërbejë si një motiv shtesë në ambicjet tuaja në rrugën e ngritjes dhe aftësimin profesional. Urime dhe suksese për të gjithë studentët”, është shprehur Hamza.

Shkolla shqipe dhe lufta e UÇK-së ia sollën lirinë Kosovës

MALISHEVË, 2 QERSHOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Malishevës, Vesel Krasniqi, me bashkëluftëtarë dhe ekipin e qeverisë lokale, ditën e 2 qershorit e ka nisur me nderimin e dëshmorëve, Ibrahim Mazreku, Kujtim Krasniqi, Ejup Kryeziu dhe Milaim Beha, të cilët kanë rënë në këtë ditë për të mos vdekur kurrë. Krasniqi ka thënë ka se e kanë obligim t'u flasim gjeneratave të reja për heroizmin e luftëtarëve të UÇK-së. “Me nderimin e dëshmorëve të kombit që ranë për lirinë e Kosovës, tash e 24 vjet më parë, sot rikujtojmë kujtimet e tyre edhe studentore si me heroin e Kosovës, Ibrahim Mazreku, ku

edhe isha i ulur në bankat e studimeve të Universiteti të Prishtinës. Kujtoj si sot ai jo vetëm që ishte ‘Tornado’, por ishte edhe sanjperist i zoti që dridhte ushtrinë pushtuese të Jugosllavisë. Prandaj kemi obligim t'u flasim nxënësve dhe pasardhësve tanë për heroizmat e luftëtarëve tanë në përballje me armikun me të vetmin qëllim që dhanë edhe jetën për lirinë e Kosovës”, ka thënë Krasniqi. Ndërsa drejtoresha e Arsimit, Arbëreshë Krasniqi, ka thënë se dëshmorët nuk kanë vdekur, por ata kanë rilindur. “Dita e rënies dhe dita e rilindjes së dëshmorëve është personifikimi më sublim,

pasi shkollat tona janë të emëruara me emrat e dëshmorëve të cilët u bënë gurthemel i lirisë së Kosovës”, ka thënë Krasniqi.

Në anën tjetër, Metush Kryeziu nga shoqatat e luftës së UÇK-së, dega në Malishevë, ka thënë se “16 qershori i '98-s dhe 16 gershori i '99-s për Malishevën është i veçantë pasi simbolizon fuqishëm dëshmorin e parë dhe të fundit të rënë për çlirimin e Kosovës”.

Për të arriturat e ShFMU “Ibrahim Mazreku” ka folur drejtoresha Rrezarta Mazreku, kurse nxënësit kanë shfaqur një program artistik.



GAP-i publikon statistikat: Ka rënë numri i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme



PRISHTINË, 2 QERSHOR (ER) - Instituti GAP ka publikuar statistikat të cilat kanë bërë me dije se numri i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme në nivel vendi ka shkuar duke rënë vazhdimisht. Sipas këtyre statistikave, rënie më të madhe të numrit të nxënësve ka në komunën e Kamenicës dhe të Junikut. “Numri i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme në nivel vendi ka shkuar duke rënë vazhdimisht. Krahasuar me vitin shkollor 2008/2009, në vitin shkollor 2021/22 mësimin e ndjekin 134 366 nxënës më pak, apo një rënie prej 30.3-përqindësh. Rënie më të madhe të numrit të nxënësve ka në komunën e Kamenicës dhe të Junikut (-53 për qind), Rahovecit, Dragashit dhe Vitisë (-45 për qind), dhe Gjilanit dhe Suharekës (-41 për qind)”, ka

njoftuar GAP-i. Ndërsa në përmbledhjen e raportit është thënë se sa i përket personelit arsimor, që përfshin mësimdhënësit, personelin administrativ dhe personelin ndihmës, numri i tyre ka mbetur thuajse i njëjtë që nga viti shkollor 2013/2014. “Sa i përket personelit arsimor, që përfshin mësimdhënësit, personelin administrativ dhe personelin ndihmës, numri i tyre ka mbetur thuajse i njëjtë që nga viti shkollor 2013/2014, kur MASHTI publikoi të dhëna të hollësishtme për këtë kategori. Në krahasim me vitin shkollor 2013/2014, në vitin shkollor 2021/2022 numri i mësimdhënësve ka rënë për -1 për qind, numri i personelit ndihmës është rritur 6 për qind, ndërsa numri i personelit administrativ ka rënë për -3 për qind”, ka njoftuar GAP-i.

Komuna e Skenderajt largon disa deponi ilegale të mbeturinave

SKENDERAJ, 2 QERSHOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se ka larguar disa deponi ilegale të mbeturinave në disa fshatra të kësaj komune. Me këtë rast, kjo komunë u ka bërë thirrje qytetarëve të

kujdesen për një ambient më të pastër. “Nga aksioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për eliminimin e deponive ilegale në vendbanimet e fshatrave Runik, Vitak, Çubrel, Radishevë, Leçinë dhe

Makërmal, për të vazhduar më pas pa u ndalur edhe në bashkësitë lokale të Likocit, Qirezit dhe Prekazit. Kujdesu për një ambient të pastër!”, ka njoftuar komuna e Skenderajt që drejtohet nga Fadil Nura.



Fryma antiamerikane, inerci nga frustrimi apo propagandë e organizuar?

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Komentet e individëve të ndryshëm në rrjete sociale, të cilat kanë pasuar pas reagimeve të pasqyruar në media dhe në rrjete sociale të zyrtarëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), lidhur me zhvillimet e fundit në veri të Kosovës, po shfrytëzohen për propagandë dhe bartin frymë antiamerikane, vlerësojnë njohësit e fushës së medias dhe të sociologjisë, Rrahman Paçarizi dhe Fadil Maloku.

Zyrtarët e ShBA-së i kanë dënuar veprimet e autoriteteve të Kosovës në komunat me shumicë serbe - Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan - ku Policia e Kosovës, më 26 maj, i ndihmoi kryetarët e rinj të këtyre komunave për qasje në objektet komunale.

Grupe të qytetarëve serbë i kanë kundërshtuar këto veprime përmes protestave, të cilat më 29 maj përshkallëzuan në dhunë, ku pati të lënduar dhjetëra pjesëtarë të KFOR-it, por edhe protestues.

Zyrtarët e ShBA-së i kanë kërkuar Qeverisë së Kosovës t'i ulë tensionet në veri të vendit si dhe kanë paralajmëruar pasoja në marrëdhëniet bilaterale.

Deklaratat e raportuara nga mediet, përmes rrjeteve sociale, kanë marrë komente të natyrës që ShBA-ja mban qëndrim "ledhatues për Serbinë", se ShBA-ja dhe BE-ja "duan t'ia japin veriu (e Kosovës) Serbisë", "Sa para po ju jep Vuçiçi", "Merre ambasadën, shko në Beograd", "Hiqeni Bondsteelin, le ta merr turku", "Ju s'keni fytyrë", si dhe komente me përmbajtje ofenduese, vulgare dhe fyese. Por, ka pasur edhe mjaft komente mbështetëse për ShBA-në, për deklaratat e zyrtarëve të saj dhe për vetë zyrtarët. Kjo jo rrallë ka krijuar përplasje verbale ndërmjet individëve në rrjete sociale.

Rrahman Paçarizi, profesor në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, thotë për "Radio Evropa e Lirë" se komentet fyese dhe ofenduese që pasojnë deklaratat e publikuara në rrjete sociale të zyrtarëve amerikanë, kryesisht vijnë nga një masë e caktuar e njerëzve të aktivizuar politikisht dhe ideologjikisht.

Sipas tij, këta njerëz edhe më parë i kanë mbështetur veprimet e qeverisë aktuale të drejtuar nga kryeministri Albin Kurti dhe partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje dhe kanë ndërtuar një narracion të tillë mbështetës që nga koha kur kjo parti ishte në opozitë. "Do të thotë, bëhet fjalë kryesisht për militantë (politikë). Nga ajo që unë kam mundur të shoh, kam vërejtur që një pjesë e mirë e këtyre llogarive në rrjete sociale janë të njëjta, janë të dyfishuara - që do të thotë se janë



të rrejshme - pasi që u takojnë personave, grupeve të caktuara, të cilat kanë bërë një fushatë në vazhdimësi. Ata janë konsistentë në veprimet e tyre. Nuk mendoj se është një masë aq e madhe, por duket masë e madhe, më shumë për shkak të profileve të rrejshme, të cilat i shfrytëzojnë për ta zhvilluar propagandën e tyre", ka thënë Paçarizi.

Ai ka theksuar se, megjithatë, kjo nuk e zvogëlon problemin, sepse "shpërthimet e tilla e rrezikojnë shoqërinë kosovare", pasi që në vazhdimësi po krijohet "një masë e njerëzve të manipuluar, të cilët nuk janë të gatshëm të zhvillojnë mendim kritik brenda vetes".

Ngjyrimet antiamerikane, "inerci nga frustrimi"

Fadil Maloku, profesor i Sociologjisë në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se reagimet me ngjyrimet antiamerikane në rrjete sociale janë rezultat i "frustrimit të qytetarëve me përplasjet politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", të cilat po zgjasin me dekada, si dhe joempancipimit të mjaftueshëm me vlerat perëndimore.

Sipas tij, reagimet e individëve të caktuar në rrjete sociale janë inerte, në kontekstin e zhvillimeve të fundit në veri të vendit, për të cilat Qeveria e Kosovës është kritikuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Nuk ka të bëjë me farë (të mbjellë) të antiamerikanizmit. Ka të bëjë me një frustrim tash. Por, natyrisht që edhe qeveria, por edhe Vetëvendosje, si koncept politik, e ka ushtrinë e saj digjitale. Me ushtri digjitale ajo i ka fituar zgjedhjet. Unë kurrë nuk mendoj që ky frustrim mund të na prishë, në fazë

afatgjatë, as me Perëndimin dhe as me Amerikën. Faktikisht, Kosova është produkt i tyre dhe interes", ka thënë Maloku.

"Si një subjekt 'anti-amerikan' mund të fitojë në vendin më proamerikan?"

"Radio Evropa e Lirë" i ka kontaktuar zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe u ka dërguar pyetjet se si i komentojnë pretendimet se prapa komenteve me ngjyrimet antiamerikane në rrjete sociale qëndrojnë individë dhe grupe militantësh të kësaj partie, si dhe si i komentojnë postimet e tilla në rrjete sociale.

Zëdhënësi i Lëvizjes Vetëvendosje, Arlind Manxhuka, në një përgjigje me shkrim ka deklaruar se "i fitojmë njohësit e mediave dhe sociologët që të ofrojnë dëshmitë e tyre të forta për këto pretendime", duke shtuar se Lëvizja Vetëvendosje i shpreh qëndrimet e saj përmes kanaleve zyrtare dhe zyrtarëve të saj. "Si mundet një subjekt 'anti-amerikan' t'i fitojë dy herë zgjedhjet dhe të ketë mbështetjen e mbi 50 për qind të qytetarëve të një vendi më pro-amerikan në botë? Kjo padyshim se është pyetje retorike", është thënë në përgjigjen e zëdhënësit të Lëvizjes Vetëvendosje.

Grupet ndikojnë tek individët?

Profesor Paçarizi nuk beson që postimet me ngjyrimet antiamerikane në rrjete sociale, nga individë të ndryshëm, janë produkt i inercisë. Sipas tij, shqiptarët e Kosovës,

përgjithësisht, shihen si më pro-amerikanët në botë dhe, si të tillë, do të duhej të silleshin me inerci mbi këtë bazë. Ai nuk e përjashton mundësinë që pakënaqësia e qytetarëve orientohet nga grupe të caktuara, për qëllime të caktuara.

Këto grupe, sipas tij, ndikojnë kryesisht tek individët, siç thotë ai, që janë "më pak të arsimuar, që kanë status më pak të avancuar shoqëror, apo edhe tek ata që fare nuk jetojnë në Kosovë dhe lidhjen me të e kanë relative". Një gjë e tillë, siç ka thënë ai, vërehet në përplasjet në rrjete sociale. "Nëse njerëz të caktuar kanë një kundërvënie të caktuar, që thotë se 'duhet të ketë koordinim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, këta persona bëhen cak i sulmeve të ndryshme bullizuese, shantazheve dhe [sulmeve] linçuese, nga këto grupe që janë të organizuara mirë. Në të vërtetë ato (grupe) janë relik i organizimit të Lëvizjes Vetëvendosje për ta marrë pushtetin (më herët). Këta persona, pastaj, kanë vazhduar të jenë aktivë dhe mund të riaktivizohen në secilën situatë, nëse ajo situatë sillet brenda narracionit, i cili është krijuar me kohë", ka thënë Paçarizi.

"Proamerikanizmi i shqiptarëve do të dëshmohej"

Profesor Maloku është pajtuar se postimet e caktuara që bartin përmbajtje fyese dhe ofenduese ndaj zyrtarëve të ShBA-së dhe vetë shtetit amerikan mund ta animojnë frymën antiamerikane. Por, sipas tij, kjo frymë nuk mund të mbizotërojë opinionin e përgjithshëm në

Kosovë dhe disponimin proamerikan të kosovarëve. "Unë nuk e besoj që mund të krijohet ndonjëherë një frymë antiamerikane. E gjithë kjo është produkt i këtyre negociatave dhe problemeve që i ka Kosova me Serbinë. Në fazë afatgjatë kjo do të tejkalohet. Jam shumë i bindur se pro-amerikanizmi i shqiptarëve do të dëshmohej në periudhat e ardhshme dhe në situatat e ndryshme që do të vijnë në horizont. Ne nuk duhet t'i marrim si parametra reagimet publike të ushtrive digjitale të njërës apo tjetrit subjekt (politik). Shqiptarët, me shumicë absolute, janë pro-Perëndimit dhe pro-Amerikës", është shprehur Maloku.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, më 26 maj ka deklaruar se i dënon fuqishëm veprimet e Qeverisë së Kosovës, të cilat, sipas tij, "po i përshkallëzojnë tensionet në veri dhe po shtojnë jostabilitetin".

Deklarata e Blinkenit pasoi reagimin, po atë ditë, të ambasadorit të ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, i cili theksoi se i dënon "veprimet e vazhdueshme të autoriteteve të Kosovës për të hyrë në ndërtesat komunale në veri të Kosovës". Shqetësimet e tyre, Blinken dhe Hovenieri i kanë përsëritur edhe më 29 maj, për shkak të rrethanave që shkaktuan tensionet në veri të Kosovës, ku pati edhe përplasje ndërmjet KFOR-it dhe protestuesve.

Më 30 maj ambasadori Hovenieri ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk është koordinuar me Shtetet e Bashkuara për veprimet e ndërmarra në veri dhe, për këtë arsye, ka pësuar pasojën e parë: "stërvitjet 'Defender Europe 2023' kanë marrë fund" për të.

ASK-ja: Qeveria për tre muaj shpenzoi 511.8 milionë euro

PRISHTINË, 2 QERSHOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar llogaritë qeveritare për tremujorin e parë 2023 (TM1), ku gjithsej të hyrat e qeverisë së përgjithshme ishin 675.8 milionë euro, që është një rritje e të hyrave krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit

paraprak, që ishin 557.6 milionë euro. Sipas ASK-së, pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë: tatimet në produkte (63.7 për qind) të totalit të të hyrave; tatimet rrjedhëse në të ardhura (16.7 për qind); transfertat e tjera aktuale (11.9 për qind); pagesat për

prodhimet jotregtare (3.7 për qind); ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave. Gjithsej shpenzimet e qeverisë së përgjithshme në TM1 2023 ishin 511.8 milionë euro, që është një rritje e shpenzimeve krahasuar me periudhën e vitit paraprak (TM1 2022), që

ishin 459.7 milionë euro. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë: kompensimi i punëtorëve (34.5 për qind); kontributet sociale dhe përfitimet (29.0 për qind); konsumi i ndërmjetëm (12.5 për qind); subvencionet (11.6 për qind); ndërsa pjesa e mbetur e



shpenzimeve është shpërndarë në kategori të tjera të shpenzimeve.

Bashkëpunimi ndërmjet shoqërive tregtare dhe administratave doganore ngritet në një tjetër nivel

BANJA LUKA, 2 QERSHOR - Bashkëpunimi ndërmjet shoqërive tregtare dhe administratave doganore të rajonit do të përmirësohet me ngritjen e Grupeve të Punës për Operatorët e Autorizuar Ekonomikë (OAE), ku sektori privat dhe strukturat shtetërore do të kontribuojnë bashkërisht në procesin e planifikimit dhe zbatimit. Ky bashkëpunim efektiv duhet të inkurajohet në nivel kombëtar edhe rajonal, me qëllim nxitjen dhe krijimin e harmonizimit rajonal dhe uljen e barrës si për tregtinë ashtu edhe për qeveritë.

Në takimin rajonal të mbajtur në Banja Luka, shoqëritë anëtare të Shoqatës OAE janë takuar me përfaqësues të administratave doganore të rajonit, ku kanë rënë dakord që

të diskutohet për përmirësime të mëtejshme të kuadrit OAE. Pjesëmarrësit ishin dakord që në secilin shtet, palë në CEFTA-a të ngriten grupe pune pasi në këtë mënyrë forcohet bashkërendimi me strukturat e tjera kufitare të përfshira në zhdoganimin e mallrave, si dhe shpejtohet zbatimi i kuadrit OAE në të gjitha ekonomitë. Statusi Operator i Autorizuar Ekonomik u jepet shoqërive tregtare që të arrijnë nivel të lartë në standardet e sigurisë së zinxhirit të furnizimit. Ky status u mundëson procedura të thjeshtuara doganore dhe kalim më të shpejtë të mallrave në ekonomitë e rajonit. I gjithë koncepti OAE synon t'i lehtësojë dhe t'i përmirësojë kushtet e tregtisë ndërmjet ekonomive të vendeve CEFTA.



Tanja Boshković, drejtuese e projektit të GIZ-it, ka deklaruar se dy elementë kyçë për zhvillimin e mëtejshëm të çdo programi të OAE-it janë forcimi i mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë me sektorin privat, si

dhe rritja e gatishmërisë dhe efektivitetit në bashkëpunim me strukturat shtetërore të përfshira në zhdoganimin e mallrave. Ndërsa Ognjen Alagić, shef i Departamentit për OAE në

Administratën Doganore të Bosnjë-Hercegovinës, ka theksuar se autoritetet doganore të Bosnjë-Hercegovinës i vlerësojnë maksimalisht përpjekjet dhe gatishmërinë e të gjithë kolegëve të rajonit për të kontribuar në përmirësimin e mjedisit të tregtisë në ekonomitë e CEFTA-s.

Takimi në Banja Luka është organizuar në kuadër të projektit "Mbështetje për Integrimin Ekonomik Rajonal" që zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Partner i kësaj ngjarjeje ka qenë projekti EDGE i USAID-it.

Kërkohet nga agjencitë turistike të pajisen me leje

PRISHTINË, 2 QERSHOR (ER) - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka njoftuar subjektet që ofrojnë veprimtari të agjencive organizatore të udhëtimit (tour operatorët) si dhe udhërrëfyesit turistike (guidat turistike), se me hyrjen në fuqi të akteve nënligjore, që dalin nga Ligji për Turizmin, obligohen të pajisen me leje për ushtrimin e veprimtarisë, respektivisht pajisjes me kartelë identifikimi dhe regjistrimit në regjistrin turizmit.

Kjo ministri nëpërmjet një njoftimi ka sqaruar se agjencitë organizatore të udhëtimit, që organizojnë paketa të udhëtimit, turne ose ekskursione, duhet të pajisen me leje për ushtrimin e veprimtarisë dhe ta sigurojnë përbushjen e detyrimeve për ofrimin e këtyre shërbimeve.



"Me përbushjen e kriterëve dhe kushteve të përcaktuara sipas ligjit për turizmin dhe akteve të tjera nënligjore, agjencitë do të mund të ofrojnë shërbime cilësore për qytetarët, respektivisht për turistët, të cilët i blejnë këto shërbime. Turistët vendorë dhe ata ndërkombëtarë

tani do të jenë të siguar, që paketa turistike të zbatohet sipas marrëveshjes kontraktuale me agjencinë organizatore. Kjo është bërë e mundur meqenëse agjencia e udhëtimit duhet ta sigurojë përbushjen e detyrimeve të saj kontraktuale ndaj palëve të treta përmes një

polise të vlefshme sigurimi. Udhërrëfyesit turistike, me rastin e regjistrimit në regjistrin e turizmit dhe pajisjes me kartelën identifikuese të lëshuar nga MINT-i, do të publikohen duke u promovuar zyrtarisht si udhërrëfyes turistike për të operuar në territorin e Republikës së Kosovës. Ndërsa nuk lejohet operimi i udhërrëfyesve turistike të huaj brenda territorit të Republikës së Kosovës pa shoqërimin e një udhërrëfyesi turistik vendor të regjistruar në MINT si parashihet me ligjin e turizmit dhe aktet nënligjore në fuqi", ka njoftuar MINT-i.

Sipas kësaj ministrie, subjektet me rastin e aplikimit për leje duhet ta kenë kartelën e identifikimit dhe ta plotësojnë formularin me të dhënat e kërkuara për përfshirje në

regjistrin e turizmit. "Deri në funksionalizimin e platformës elektronike të 'Regjistrin të Turizmit' aplikimet bëhen në formën fizike për pajisjen me leje për agjencitë organizatore të udhëtimit dhe kartelë identifikimi dhe regjistrim të udhërrëfyesve turistike. Po ashtu, njoftohen operatorët ekonomikë se me hyrjen në fuqi të këtyre udhëzimeve administrative, agjencitë organizatore dhe udhërrëfyesit turistike obligohen të pajisen me leje për ushtrimin e veprimtarisë, respektivisht pajisjes me kartelë identifikimi dhe regjistrimi në regjistrin e turizmit, në të kundërt Ministria do të veprojë sipas procedurave të mbikëqyrjes dhe inspektimit të paraparë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi", ka njoftuar MINT-i.

Bien të ardhurat nga renta minerare në Shqipëri

TIRANË, 2 QERSHOR - Të ardhurat nga renta minerare në Shqipëri gjatë katërmujorit të parë të vitit janë realizuar në vlerën 1.1 miliard lekë. Referuar të dhënave të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë së Shqipërisë, të ardhurat nga

renta janë 397 milionë më të ulëta se në katërmujorin e parë të vitit 2022. Sipas ekspertëve, ulja e të ardhurave në buxhet ka ardhur për shkak të efektit të uljes së çmimit të bursës, por edhe zhvlerësimit të euros kundrejt lekut. "Të ardhurat nga renta minerare

në eksport janë realizuar në vlerën 1.1 miliard lekë, 394 milionë ose 27.2 për qind më pak krahasuar me vitin e kaluar dhe realizim në masën 70.8 për qind kundrejt planit", ka bërë me dije Ministria e Financave dhe e Ekonomisë së Shqipërisë.



Vullneti i lirë: Pse njerëzit besojnë tek ai edhe kur mendojnë se po manipulohen



Nga Magda OSMAN

Të gjithëve na pëlqen të besojmë se jemi të lirë që të bëjmë zgjedhjet tona. Njëkohësisht, shumë njerëz mendojnë se po përdoren vazhdimisht teknika të ndryshme psikologjike për të ndikuar tek ne, nga tendencat e mediave sociale tek reklamat. Atëherë, si ta zgjidhim këtë problem?

Çuditërisht, është një pyetje e shpërfillur deri vonë nga shumica e studiuesve. Por në një seri studimesh të kohëve fundit, ne i pyetëm njerëzit: “Ku mendoni se po përdoren në jetën tuaj të përditshme taktika psikologjike për t’ju manipuluar në mënyrë të pandërgjegjshme?” Dhe panë se çfarë do të thoshte kjo për besimin e tyre në vullnetin e lirë.

Në një studim të vitit 2018 në 4 vende (Australi, Kanada, Britani e Madhe dhe SHBA), përgjigjet ndaj pyetjes së mësipërme ishin shumë të ngjashme. Në fakt, ato dominojnë pavarësisht moshës, gjinisë, fesë dhe përkatësisë politike.

Në afro 45 për qind të shembujve që dhanë njerëzit mbi manipulimin psikologjik, iu referuan marketingut dhe reklamimit. Sidomos “reklamimit nënkuptimor” (pra duke përdorur imazhe ose tinguj për të joshur ose

bindur njerëzit se ata nuk janë të vetëdijshëm).

Ndërkohë mënyra tjetër më e zakonshme (19 për qind) ishte kërkimi (si përdorimi i efektit placebo), pastaj vinte fushata politike (7 për qind), mediat sociale (4 për qind) dhe hipnoterapia (4 për qind). Zakonisht njerëzit përshkruan metoda, të cilat ndryshojnë humorin, emocionet dhe mendimet në atë formë që të na bindin të zgjedhim ose të bëjmë gjëra që nuk i kemi pranuar me vetëdije.

Për shembull, furrat mund të lejojnë daljen e aromës së bukës së freskët të pjekur jashtë dyqani për t’i joshur njerëzit të futen brenda. Ndërkohë gjatë një fjalimi, një politikan mund ta vërë theksin tek fjalë specifike për t’i bindur njerëzit që t’i mbështesin. Pavarësisht se e dimë se mund të ndodhë një gjë e tillë, zakonisht ne nuk mund të jemi të sigurt se po manipulohemi në këtë mënyrë. Por a funksionojnë vërtet metoda të tilla? Studimet psikologjike nuk kanë gjetur një përgjigje të prerë për këtë pyetje. Por është interesante të reflektojmë se si ndikon e gjitha kjo në besimin tonë tek vullneti i lirë. Ne vendosëm të hulumtojmë mbi këtë temë gjatë 2 viteve të fundit. Në 8 studime të ndara kemi përfshirë 1230 njerëz në disa skenarë bazuar në shembujt e

mëparshëm. Skenarët ishin nga një sërë kontekstesh (marketing/reklamim, kërkime, fushata politike, media sociale, terapi). Për secilin skenar, njerëzit duhej të vlerësonin shkallën në të cilën ata besonin se kishte manipulim të pavetëdijshëm dhe masën në të cilën ruhej zgjedhja e lirë.

Secili person duhej të jepte disa herë vlerësimet mbi zgjedhjen e lirë dhe vlerësimet në lidhje me manipulimin e pavetëdijshëm, dhe duhej ta bënte këtë për secilin nga skenarët që iu paraqit. Përmbledhja e të gjitha vlerësimeve të dhëna në të 8 studimet me 1.230 pjesëmarrësit, gjeneroi mbi 14.000 përgjigje.

3.7 për qind prej tyre e vlerësuan me zero lirinë e zgjedhjes, 8.4 për qind e vlerësuan në maksimum (me 10) lirinë e zgjedhjes, ndërsa pjesa tjetër ishte diku në mes. Këto të dhëna janë ende të papërpunuara, por na japin gjithsesi një përshtypje se edhe aty ku përshkruhej se po ndodhte manipulimi, kishte proporcionalisht më shumë atribuiime të zgjedhjes së plotë të lirë sesa të mungesës së saj.

Pra në përgjithësi, njerëzit kishin më shumë gjasa të mendonin se kishin zgjedhje të plotë të lirë sesa aspak liri në këtë aspekt. Por nga ana tjetër kanë më shumë gjasa të besojnë se ndonjëherë po manipuloheshin. Ne pritëm që të

gjenim atë që studiuesit e quajnë një lidhje negative.

Pra që sa më shumë njerëzit mendojnë se po manipulohen, aq më pak besojnë se kanë vullnet të lirë. Por nuk gjetëm diçka të tillë. Në shumicën e studimeve, nuk kishte asnjë lidhje të besueshme midis të dyjave. Si mund të ndodhë kjo? Një arsye për këtë është mënyra se si ne mendojmë në lidhje me metodat e manipulimit.

Shanset janë që ne të mos mendojmë se ato do të funksionojnë shumë mirë me ne, duke i lënë njerëzit të besojnë se ata mbeten në krye të zgjedhjeve të tyre. Gjithsesi, ne zbuluam një diferencë kur njerëzit jepnin vlerësime nga një këndvështrim jo-personal dhe kur atyre u kërkohet të imagjinojnë veten në skenarë.

Sa më shumë që njerëzit e imagjinojnë mundësinë e manipulimit, aq më shumë e shihnin të çënuar zgjedhjen e tyre të lirë. Por shanset janë që ne jemi të njëanshëm, dhe të mendojmë për të tjerët si më të manipuluar sesa për veten tonë. Ndërkohë, as skenarët nuk ishin të barabartë. Disa njerëzve nuk u interesonte veçanërisht nëse mund të ketë manipulime.


Nëse taktikat e marketingut dhe reklamimit na shtojnë të zgjedhim një markë të lirë të pastës së

dhëmbëve në krahasim me një tjetër, atëherë për sa kohë që po kursejmë para, kjo gjë nuk ka rëndësi. Pra, njerëzit e justifikojnë besimin e tyre në vullnetin e lirë duke supozuar se manipulimi ndodh vetëm për situata për të cilat nuk u intereson, apo që ata zgjedhin në mënyrë aktive të manipulohen, pra e lënë vetë që të ndodhë.

Kjo mund të jetë një qasje e arsyeshme për reklamimin. Por nëse do të hyjmë në një kabinë votimi, do të duam të pretendojmë se është zgjedhja jonë e lirë se për kë po votojmë, dhe jo një kombinim taktikash psikologjike që ndërhyjnë në pavetëdijen tonë. Në një situatë të tillë, kemi më shumë gjasa të besojmë se nuk po ndodh asnjë manipulim, apo se jemi disi të imunizuar ndaj tij.

Ajo që na tregojnë gjetjet nga studimi ynë, është se në një nivel themelor ne duam të ruajmë besimin se jemi të lirë të zgjedhim. Por se sa e ruajmë besimin, duket se varet nga ajo që është në rrezik. Ndërsa mund të duket e paarsyeshme, është në fakt e dobishme dhe e shëndetshme. Tek e fundit, bota siç e njohim ne do të shembej totalisht, në rast se ne do të refuzonim të besojmë se jemi përgjegjës për veprimet tona. / “The Conversation” – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Mediumi zviceran: Bayerni ka bërë ofertë për Xhakën

MUNCHEN, 2 QERSHOR - Skuadra kampione e Gjermanisë, Bayern Munchen, është futur në garë për transferimin e mesfushorit shqiptar Granit

Xhaka. Sipas raportimeve nga mediumi zviceran "4-4-2.ch", Bayerni tashmë ka bërë ofertë për kapitenin e Kombëtares së Zvicrës. Thuhet se Bayerni do

t'i ofrojë kontratë trevjeçare Xhakës me mundësi për një tjetër vit shtesë. Përpos Bayernit, është raportuar se interesim ka shprehur edhe

skuadra e Bayern Leverkusenit. Me shumë mundësi Xhaka do të largohet nga Arsenalin në ditët në vazhdim.



Federata rumune i këshillon tifozët të kenë kujdes gjatë qëndrimit në Kosovë

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Federata e Futbollit e Rumanisë i ka këshilluar tifozët e kombëtares së vet që të kenë kujdes gjatë qëndrimit në Kosovë për ndeshjet kualifikuese për "Euro 2024". Shkak për këtë këshillë federata ka marrë nga ngjarjet e fundit në veri të vendit. Të gjithë qytetarëve rumunë që dëshirojnë të vijnë në Kosovë, Federata i këshillon që të hyjnë përmes kufirit me Maqedoninë ose me Serbinë, por vetëm në pikën e Merdarit, dhe jo nga Jarinja apo Bërnjaku. "Situata e sigurisë në veri të Kosovës mund të përkeqësohet edhe më shumë në të ardhmen e afërt. Për shtetasit rumunë që dëshirojnë të shkojnë në Kosovë, rekomandojmë që hyrja në këtë hapësirë të bëhet në kufirin me Maqedoninë e Veriut (Hani i Elezit - në veri të Shkupit) ose me Serbinë (Merdat). Ne nuk rekomandojmë hyrjen në Kosovë përmes Bërnjakut dhe

Jarinjes, pasi ato mund të bllokohen ose mbyllen nga autoritetet e Kosovës me mbështetjen e trupave të KFOR-it, nëse situata e sigurisë përkeqësohet ndjeshëm", thuhet në njoftimin e FRF-jë. Gjithashtu, FRF-ja ka kërkuar nga fansat që gjatë qëndrimit në Kosovë të mos bëjnë deklaratime politike, për arsye se Rumania është një nga vendet e BE-së që nuk e njeh Kosovën, dhe tifozët e këtij vendi shpesh shfaqin pankarta nëpër stadione me mesazhe përkrahëse për Serbinë. "Gjithashtu, u rekomandojmë përkrahësve rumunë që gjatë udhëtimit në Kosovë, veçanërisht në stadium, të mos këndojnë apo shfaqin mesazhe politike që mund të sjellin reagime nga shikuesit nikoqirë", ka shtuar Federata Rumune e Futbollit. Si pasojë e situatës së fundit në Kosovë, Federata Rumune e Futbollit ka krijuar një grup



punues në nivel të institucionit dhe filloi një dialog me Ministrinë e Punëve të Jashtme për këtë temë. Federata thotë se e vë në plan të parë sigurinë e të gjithë të përfshirëve. "Për këtë, përveç dialogut që ka pasur dhe

vazhdon të ketë me Ministrinë e Punëve të Jashtme, ajo iu drejtua edhe UEFA-s për të kërkuar sqarime në lidhje me ndeshjen që Kombëtarja do të luajë në Kosovë në kuadër të 'Euro 2024', më 16 qershor 2023. Deri në këtë

pikë nuk është marrë parasysh ndryshimi i vendit të lojës", ka theksuar Federata Rumune e Futbollit. Kosova është renditur në Grupin I së bashku me Zvicrën, Rumaninë, Izraelin, Bjellorusinë dhe Andorrën.

Grumbullohet Kosova U20, i bashkohet Aстера Tuhina



PRISHTINË, 2 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës U-20 e vajzave do ta vazhdojë fazën e dytë përgatitore. Vashat e drejtuara nga ish-basketbollistja Shemsije Stublla tani në rolin e trajneres do të vazhdojë përgatitjet në palestrën "Shani Nushi" në Gjakovë nga 3 deri më 8 qershor. Shemsije Stublla do të ndihmohet nga dy ndihmësit e saj, Qëndrim

Demi dhe Marko Roder, për të parë nga afër formën e vajzave dardane. Në këtë grumbullim janë ftuar gjithsej 17 vajza nga klube të ndryshme të Kosovës, si dhe basketbolliste të cilat karrierën e tyre janë duke e vazhduar jashtë Kosovës, në mesin e tyre edhe Aстера Tuhina. Kosova U-20 Vajzat gjendet në Grupin C me Holandën, Kroacinë dhe Slloveninë. Kampionati do të

zhvillohet në Kraiova të Rumanisë nga 28 korriku deri më 6 gusht.

Lista e basketbollisteve: Alma Muzliukaj, Anesa Korqa, Anila Selmani, Anita Grainca, Arba Hashani, Aстера Tuhina, Blerta Mehana, Elza Maliqi, Enisa Kamerolli, Erzana Mulakeri, Etna Rexhepi, Olta Zymbëri, Rea Ukaj, Sumeja Kosumi, Vanesa Bojku, Viola Sylja, Yllza Uka.

Në fundjavë turneu final i ligës së juniorëve në hendboll

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Të shtunën e të dielën në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë zhvillohet turneu final (Final4) i ligës së juniorëve të Kosovës në hendboll. Pas një gare interesante në grupe, katër skuadrat më të mira luftojnë për titull të kampionit. Në gjysmëfinalen e parë

takohen Besa Famgas dhe Trepça. Besa ishte e para në grupin B, ndërsa Trepça e dyta në grupin A. Kjo ndeshje zhvillohet prej orës 17:00. Prej orës 19:00 është takimi Prishtina - Vëllaznimi. Prishtina ka përfunduar fazën grupore në pozitën e parë në grupin A, ndërsa Vëllaznimi

ishte i dyti në grupin B. Të dielën prej orës 17:00 është ndeshja për vend të tretë, ndërsa prej orës 19:00 është finalja. Ndërkohë po vazhdon gara në ligën e pionierëve dhe pionierëve dhe pionierëve. Këtë fundjavë ndeshjet zhvillohen në Vushtrri, Deçan, Mitrovicë, Shtime, Klinë e Gjakovë.



Denveri fiton finalen e parë ndaj Miamit

DENVER, 2 QERSHOR - Skuadra e Denver Nuggets fitoi me rezultat 104-93 ndaj Miami Heatit në finalen e parë të "play-off"-it në NBA, duke udhëhequr 1-0 serinë e ndeshjeve për titullin kampion.

Një fitore e merituar e skuadrës vendase, që kishte 10 ditë kohë për ta përgatitur këtë sfidë, ndërsa rivalët nga Florida vetëm tri të tilla. Gjithsesi, në fushë u zhvillua një ndeshje me së shumti e ekuilibruar, ku për

Denverin u dallua i zakonshmi Nikola Jokiq, autor i një "triple double". Ai e mbylli ndeshjen me 27 pikë, 10 rebounde e 14 asistime, mbështetur edhe nga Jamal Murray me 26 pikë e 10 asistime. Për Miamin u dallua

Bam Adebayo me 26 pikë e 13 rebounde, por zhgënjeu Jimmy Butler me vetëm 13 pikë. Edhe ndeshja e dytë finale do të luhet në fushën e Denverit, pas 48 orësh dhe më pas seria do të spostohet në Florida.



Boksieri i pamposhtur amerikan: Do ta kem për nder t'i tregoj vendin Furyt

UASHINGTON, 2 QERSHOR - Boksieri 34-vjeçar amerikan Jarrell Miller, i pamposhtur në karrierën e tij (26 fitore e 1 barazim), ka deklaruar për "Daily Mail" se ai është për momentin kandidati më i fortë dhe më i mirë për të dueluar për titullin kampion në peshën e rëndë. Për pasojë, ai e fton në duel boksierin e pamposhtur britanik Tyson Fury, që mban titullin e kategorisë WBC. Fury nuk ka gjetur ende një rival për të dueluar këtë vit edhe pse është përfolur për disa emra, si Anthony Joshua, Zhilei Xhang apo një rival nga Australia (Damsey McKean). Madje është përfolur edhe për një sfidë me kampionin e botës në peshën e rëndë në artet marcialle mikse (MMA), Jon Jones. Miller, përmes një postimi në rrjetet sociale, fton Furyt në ring: "Dëgjo, i thoni atij djali, Tyson Fury, se kam dëgjuar se po kërkon një rival për t'u përballur. Mjaft u



përdrode, ti e di se kush është më i mirë, opsioni yt më i mirë". "Djali që po kërkon është këtu, para teje dhe të sfidon. Njerëzit e tu le të telefonojnë, të punojmë për paratë dhe ta organizojmë

duelin. Gypsy King kundër Big Baby, është e bukur edhe kur e dëgjon. Do të ishte një nder për mua ta mundja bythën tënde. Le ta organizojmë këtë sfidë", ka deklaruar Miller.

Ibra: Nuk e kam ndërmend të tërhiqem

MILANO, 2 QERSHOR - Sulmuesi suedez Zlatan Ibrahimović, në një intervistë për "Gazzetta Dello Sport", ka folur për të ardhmen e tij. "Jam mirë fizikisht. Kam punuar shumë dhe kam kaluar limitet e mia. Jo vetëm këtë vit, por edhe gjatë vitit të kaluar", u shpreh sulmuesi 41-vjeçar. "Kur isha i dëmtuar jam munduar të ndihmoj grupin kur kishte nevojë. Kur ke një profesion që e bën përgjatë gjithë jetës dhe kur e di se çfarë duhet të bësh, por nuk ka mundësi ta bësh, atëherë ndihesh keq. Kur vjen dëmtimi nuk ke ç'të bësh, duhet ta pranosh edhe atë", ka shtuar Ibra. "Koka ime është e fortë. Ndihej Superman sa herë që rikthehem në fushë. Gjithsesi, duhet ta ruaj ekuilibrin mes futbollit dhe jetës. Kam sforcuar shumë për t'u rikthyer dhe për të dhënë gjithçka në fushë dhe nuk



kam marrë gjithnjë atë që meritoja. Unë jam një njeri që nuk heq dorë, por njeriu duhet të gjejë kënaqësi në atë që bën. Nuk e kam ndërmend të tërhiqem, jam ende jam larg asaj date, nuk e mendoj

largimin nga sporti. Besoj se do të rikthehem të luaj, por duhet ta gjej ekuilibrin në jetën time. Nëse nuk kam qetësi, ekuilibër dhe stabilitet, jam si një bombë që shpërthen", ka deklaruar Ibrahimović.

SHKURT

Hasani nga Shkëndija transferohet në Danimarkë

Ferhan Hasani i dha fund aventurës së tretë me Shkëndijën. Kapiteni e mbylli me kuqezinjtë nga Tetova dhe është transferuar në futbollin danez. 32-vjeçari ka firmosur deri në vitin 2025 me Helsingorin, skuadër që garon në divizionin e dytë të futbollit danez. Në sezonin e ardhshëm do të tentojë rikthimin në elitë. "Buba" ka një përvojë të madhe. Mesfushori ofensiv ka veshur 43 herë fanellën e Maqedonisë së Veriut, teksa ka luajtur me skuadra si Wolfsburg, Helsinki, Al Raed. Hasani provoi edhe një aventurë të shkurtër në Superiore me Partizanin, ndërkohë që rikthehet pas tetë vjetësh në Danimarkë. Lojtari nga Tetova ishte pjesë e Brøndby në vitet 2013-2015. Tani rikthehet sërish në shtetin skandinav për ta ndihmuar Helsingorin për t'u ngjitur në Superligë.

Ronaldo: Messi dhe Benzema janë të mirëseardhur në Arabi

Cristiano Ronaldo është shprehur i hapur që lojtarë të mëdhenj si Lionel Messi dhe Karim Benzema ta ndjekin shembullin e tij dhe të transferohen te klubet e Arabisë Saudite. Pesë herë "Topi i Artë" që iu bashkua Al-Nassri në janar, përflitej për një largim gjatë kësaj vere, por ai i hodhi poshtë këto spekulime në intervistën e dhënë së fundmi për Saudi Pro League. "Ata janë të mirëseardhur... liga do të përmirësohet dhe, së fundi, ka lojtarë të mrekullueshëm të huaj dhe arabë", ka thënë Ronaldo.

Dybala: Të luash për Romën është nder

Ylli argjentinas i Romës, Paulo Dybala ka konfirmuar se dëshiron ta vazhdojë karrierën te Roma pas humbjes së finales së Ligës së Evropës ndaj Sevilas. "Të luash për këtë ekip nuk është thjesht një sport apo punë, por një nder", është shprehur Dybala. Mesfushori ia bashkua ekipit të Romës vetëm verën e kaluar si lojtar i lirë dhe ka qenë një nga lojtarët kryesor për ekipin e Mourinhos edhe për arritjen deri në finale të Ligës së Evropës. Në finalen e dy ditëve më parë, Dybala nuk ia doli ta përfundojë ndeshjen duke luajtur vetëm 67 minuta për shkak të një problemi në kyçin e këmbës.

Inzaghi: Nuk jemi favoritë përballë Cityt

Trajneri i Interit, Simone Inzaghi, e pranon se në finalen e Ligës së Kampionëve nuk është favorit përballë kampionëve anglezë të Manchester Cityt. Finalja do të luhet më 10 qershor në Stamboll, me ekipin e Guardiola që duket me pranë se kurrë fitimit të trofeut të parë të këtij kompetecioni, edhe pse vitet e fundit i ka shkuar shumë pranë, nuk ia ka dalë. "Sigurisht që nuk po e nisim si favoritë, por kjo është ajo që e bën futbollin kaq të mrekullueshëm", u shpreh Inzaghi.

Haaland: Dua tripletën, e kam ëndërr

Në vitin e tij të parë në ishull, Erling Haaland theu të gjithë rekordet e mundshme, ndërsa në fund festoi titullin në Premierë Ligë. Ky është vetëm fillimi për biondin norvegjez pasi në program janë dhe dy

finale të tjera, dy trofe të tjerë të mundshëm, finalja e FA Cup përballë Manchester Unitedit më 3 qershor dhe finalja e madhe e Ligës së Kampionëve kundër Interit më 10 qershor në Stamboll. Në një intervistë për

BBC, Haalandi nuk e fsheh faktin që ideja e fitimit të një triplete të mundshme e josh shumë: "Do të ishte e pabesueshme të sillnim në shtëpi tripletën, edhe pse më duhet ta pranoj se në fund të fundit klubi për këtë më

bleu. Nuk duhet të fshihemi, duhet të synojmë këtë objektivi në mënyrë që të kemi mundësi ta realizojmë. Kjo është ëndrra ime më e madhe dhe shpresoj ta realizoj. Sigurisht nuk do të jetë e lehtë, janë dy finale

kundër dy ekipeve të mira. Edhe ata do të jenë të motivuar dhe të do të japin gjithçka për të fituar. Nëse luajmë në mënyrë tonë, nëse do të luajmë në maksimumin tonë, kam besim se do t'i fitojmë të dy trofetë".



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULË

gluten
free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues